



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1605/3 Prot.

Tiranë, më 30.10.2025

V E N D I M

Nr. 59 Datë 30.10 2025

**“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE TË PUNËS TË KRYERA NË DITËT E
PUSHIMIT PËR PERSONELIN NDIHMËS AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në zbatim nenit 90, pika 1, pika 2, nenit 91, pika 3, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në RSH" i ndryshuar, VKM nr. 568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore", KREU II "Kohëzgjatja e punës dhe orët shtesë", në VKM nr.326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa insitucione të administratës publike", në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.16, datë 16.06.2023 "Për mënyrën e zbatimit të VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civil/nënpunësve, zëvendësministrit dhe nënpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike" në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.08, datë 29.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimin e pagës për vitin 2025", në Urdhrin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar nr. 157, datë 03.06.2025 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026", Urdhrin e Përbashkët të Rektorit nr. 19, datë 25.07.2025 "Për zbatim të Urdhrit të Përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 të QSHA dhe QNRRASH, "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026, raundi i parë", Urdhrin e Rektorit nr. 24, datë 15.09.2025 "Për zbatim të Urdhrit të Përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 të QSHA dhe QNRRASH, "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026, raundi i dytë", në shkresën e Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 2545/2 prot., datë 23.10.2025 "Dërgim kërkesë për pagesë të orëve jashtë orarit zyrtar", në shkresën e Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko Shkencore me nr. 2545 prot, datë 21.10.2025 "Përcjellje të kërkesës për pagesën e orëve jashtë orarit", në shkresën e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët me nr. 2545/1 prot., datë 21.10.2025 "Përcjellje të kërkesës për pagesën e orëve jashtë orarit për DMJPS", në shkresën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit me nr. 2545/3 prot, datë 23.10.2025 "Përcjellje e kërkesës për pagesën e orëve jashtë orarit të Znj. Valentina Gabeci", në shkresën e Drejtorisë së Juridike dhe Zhvillimit të Kurrikulave me nr. 2545/5

prot., datë 24.10.2025 "Përcjellje e kërkesës për pagesën e orëve jashtë orarit të Znj. Elona Osmani", në shkresën e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse me nr. 2545/4 prot., datë 23.10.2025 "Kërkesë për pagesë të orëve jashtë orarit", në relacionin përkatës të Administratorit nr 2597 datë 28.10.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30.10.2025

V E N D O S I :

1. Miratimin e pagesës së orëve të punës të kryera në ditët e pushimit për personelin ndihmës akademik dhe administrativ, sipas tabelës bashkëklidhur;
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

